



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:055328
Datë: 11.12.2023
Numri i dokumentit: 05043437

C.nr.2432/20

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, në përbërje me gjyqtarin Ibrahim Maloku si dhe me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Festim Zeqiri, duke vendosur në çështjen juridiko-civile të paditësit I.M nga fshati Sh. Komuna Obiliq, kundër të paditurës Ndërmarrja Hidroekonomike “Ibër - Lepenc” Sh.a, të cilën me autorizim e përfaqëson N.S, juriste pranë të paditurës, me objekt të kërkesëpadisë vërtetim pronësie, pas mbajtjes së seancës kryesore të datës 23.11.2023, gjykata me datë 11.12.2023 nxori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tersi e pabazuar kërkesëpadia e paditësit I.M, nga fshati Sh. Komuna Obiliq, përmes së cilës ka kërkuar që të : “APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditësit I.M,nga fshati Sh, Komuna Obiliq dhe VËRTETOHET se paditësi është pronar i ngastrës kadastrale nr. -0, parcelë rurale, në vendin e quajtur ”” në Fshatin, Komuna, sipas planit kadastral dhe gjendjes faktike në terren: prej pikës 1-2 gjatësia e frontit është 7.11 m; prej pikës 2-3 gjatësia e frontit është 3.03m; prej pikës 3-4 gjatësia e frontit është 17.53m; prej pikës 4-5 gjatësia e frontit është 9.18m; prej pikës 5-6 gjatësia e frontit është 8.19 m; prej pikës 6-7 gjatësia e frontit është 8.40m; prej pikës 7-8 gjatësia e frontit është 10.27m,; prej pikës 8-9 gjatësia e frontit është 7.36m; prej pikës 9-10 gjatësia e frontit është 7.09m; prej pikës 10-11 gjatësia e frontit është 9.30m; prej pikës 11-12 gjatësia e frontit është 18.54m; prej pikës 12-1 gjatësia e frontit është 19.25m; prej pikës 3-13 gjatësia e frontit është 5.58m; prej pikës 13-14 gjatësia e frontit është 5.62m; prej pikës 14-15 gjatësia e frontit është 5.63m; prej pikës 15-16 gjatësia e frontit është 3.32; prej pikës 16-17 gjatësia e frontit është 5.43m; prej pikës 17-18 gjatësia e frontit është 5.67 m; prej pikës 18-19 gjatësia e frontit është 6.28m; prej pikës 19-20 gjatësia e frontit është 3.70 dhe prej pikës 20-9 gjatësia e frontit është 3.05m.

- Ngastra kadastrale ____-0 është tokë rurale tipi i pronës është shoqërore, sipas elaboratit kadastrim kufizohet me këto ngastra kadastrale dhe prona nga ana veriore dhe lindore kufizohet me ngastrën kadastrale ____-0 dhe ____-0 të cilat evidentohet në pronë të N.H “Ibër Lepenci” sha Prishtinë dhe ngastra kadastrale ____-0, që evidentohet në emër të IM, nga ana jugore kufizohet me ngastrën kadastrale ____-0 evidentohet në emër të NM dhe nga ana perëndimore me ngastrën kadastrale ____-0, e cila evidentohet në emër të PSH Rrugët KK Obiliq.”

II. Secila palë i bart shpenzimet veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi, në këtë gjykatë, me datë 19.11.2010 ka paraqitur padinë kundër të paditurës P.SH Ibër Lepenci për vërtetim të drejtës së pronësisë. Lidhur me këtë lëndë, gjykata ka zhvilluar procedurën kontestimore në drejtim të vendosjes në mënyrë meritore dhe me datë 18.10.2016 ka nxjerrë Aktgjykimin C.nr.2464/2010 përmes të cilit në tersi e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit. Në bazë të procedurës ankimore të zhvilluar në bazë të ankesës së të paditurës, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit Ac.nr.277/17 të datës 27.04.2020 ka prishur këtë aktgjykim dhe lëndën ia ka kthyer në rigjykim dhe rivendosje gjykatës së shkallës së parë.

Pas pranimit të lëndës, analizimit të vërejtjeve të dhëna nga gjykata e apelit dhe me qëllim të eliminimit të të njëjtave, në rigjykim gjykata ka mbajtur seancë përgatitore për datën 23.11.2023 në të cilën kan prezantuar palët ndërgjyqëse.

Paditësi I.M,lidhur me padinë dhe kërkesëpadinë është deklaruar se qëndron pranë padisë dhe kërkesës së saj duke theksuar se babai i paditësit ka qenë pronar i ngastrës ____ -0 në sipërfaqe prej 0.08.63ha dhe me aktvendimin e Sekretariatit për Finanaca të Kuvendit të Komunës së Prishtinës 07 nr.465-23/81 të datës 10.07.1981 është bërë eksproprijimi i ngastrës lëndore në favor të të paditurës me qëllim të ndërtimit të deponisë së materialit për hyrjen në tunel “ ____ ” dhe mbi bazën e këtij aktvendimi, e paditura është regjistruar edhe pronare e ngastrës. Ka shtuar se e

edhe pse prona është eksproprijuar në favor të të paditurës e njëjta nuk ka ndërmarrë asnjë veprim juridik për ndërtimin e deponisë së materialit për qëllimin për çka është eksproprijuar, andaj meqenëse e paditura nuk e ka bërë kompensimin e pasurisë si dhe të njëjtën nuk e shfrytëzon për qëllimin për të cilin është eksproprijuar paditësit konsideron se e paditura ka heqë dorë nga eksproprijimi i pronës lëndore ngase nga koha e eksproprijimit e deri më tani ka kaluar një kohë e gjatë ndërsa aktvendimi mbi eksproprijim asnjëherë nuk është zbatuar nga e paditura.

Edhe në rigjykim paditësi ka deklaruar se kërkesë kryesore nga gjykata, ka që parcela ____ -0, t'i kthehet në pronësi, pasi që e paditura të njëjtin e ka bartur në pronësi të saj, ndërsa kompensimin lidhur me këtë shpronësim nuk ia ka bërë paditësit asnjëherë dhe këtë ndryshim të pronësisë paditësi e ka kuptuar pas luftës kur ka bërë bartjen e pronësisë së tokave në emër të tij, mbi bazën e të lartcekurave i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta aprovoj në tersi të bazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

E paditura lidhur me kërkesëpadinë e paditësit është deklaruar se të njëjtin e kundërshton në tersi duke e kontestuar edhe legjitimitetin aktiv të paditësit pasi që i njëjti në kohën e shpronësimit nuk ka qenë pronar legjitim i ngastrës objekt shqyrtimi. Gjithashtu e paditura e ka kontestuar edhe legjitimitetin pasive për të qenë e paditur me arsyetimin se e paditura vetëm ka bërë propozimin për shpronësimin e ngastrës lëndore, ndërsa bartës i procedurave të shpronësimit ka qenë ish sekretariati për Ekonomi dhe Financa i Komunës së Prishtinës. Andaj sipas Ligjit për Ndërmarrje Publike Ibër Lepenc është ndërmarrje publike qendrore që nënkupton se pronare e saj 100% është Republika e Kosovës përkatësisht Qeveria e që kjo nënkupton se e paditura administron me të gjitha asetet e saj por që pronar është shteti i Kosovës, andaj mbi këtë bazë ka theksuar se e paditura nuk ka legjitimitet pasive për të qenë palë në procedurë.

Gjithashtu e paditura kërkesëpadinë e paditësit e ka kundërshtuar edhe në baza tjera për faktin se, paditësi i ka lëshuar të gjitha afatet kohore për paraqitje të padisë të parapara me ligjin për eksproprijim GZ 21/1978 në nenin 21, pasi që në këtë rast aktvendimi 07NR465-23/81 për eksproprijim e ngastrës lëndore ka marrë formë të prerë me datë 10.07.1981, ndërsa paditësi ka paraqitur padinë e tij në vitin 2010 përkatësisht mbas 3 dekadave e që në rastin konkret ka parashkrim absolut.

Tutje e autorizuara e paditësit ka theksuar se sipas ligjit për eksproprijim është përcaktuar se regjistrimi i pronësisë dhe i të drejtave tjera në pasurinë e patundshme të eksproprijuar mund të bëhet vetëm nëse shfrytëzuesi i eksproprijimit përveç dokumenteve tjera paraqet edhe dëshminë e shpërblimit dhe vërtetimin e bankës se e ka paguar pasurinë e patundshme dhe vetëm atëherë mund të regjistrohet në regjistrin kadastral. Andaj përderisa e paditura e ka patur të regjistruar në regjistrin kadastral ngastrën e eksproprijuar nënkupton se të gjitha kompensimet lidhur me eksproprijim janë kryer. Pavarësisht nga kjo edhe me pretendimin e paditësit se nuk janë kryer kompensimi në këtë rast i bie se kemi parashkrim absolut sipas LDM-së edhe sikur paditësi të ishte person me legjitimitet aktiv.

Lidhur me pretendimet se e paditura nuk e shfrytëzon pronën dhe se e paditura nuk ka ndërtuar objektin e paditura ka theksuar se prona e cila është eksproprijuar është me destinim për depo, e jo për deponim që nënkupton se jo të ndërtohet ndonjë objekt por do të shfrytëzohet për bartje të mbetjeve sipas nevojës nga e paditura kurdo që i vie radha për shfrytëzim. Mbi bazën e të lartcekurave, i ka propozuar gjykatës që padinë e paditësit ta refuzoj në tersi të pabazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, gjykata ka bërë administrimin e provave materiale në shkresat e lëndës dhe atë: Aktvendimi 07.nr.465-23/81 i datës 10.07.1981, Fletën poseduese nr.27 në emër të J,M, Aktvendimin mbi trashëgiminë T.nr.191/2002 të datës 22.10.2002, Aktvendimin e lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë e Komunës së Obiliqit e datës 25.11.2002, Ekspertizën gjeodezike të datës 15.08.2013, Certifikatën me numër të lëndës 05-1568-23 e datës 17.10.2023 lëshuar nga Komuna e Obiliqit për ngastrën kadastrale P-____-____-0.

Pasi që Gjykata bërë vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në nenin 8 të LPK-së arriti në përfundim se në këtë çështje juridike duhet të vendoset si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga Aktvendimi 07.nr.465-23/81 i datës 10.07.1981, gjykata gjeti se në bazë të vendimit të Sekretariatit Financiar të Komunës së Prishtinës, për nevojat e ndërmarrjes Iber Lepenci është kryer eksproprijimi i disa parcelave në Sh. ku ndër to është edhe ngastra ____ në sipërfaqe prej 0,08.63 ha e cila evidentohet në pronësi të J,M

Nga aktvendimin mbi trashëgiminë T.nr.191/2002 të datës 22.10.2002 lëshuar nga Gjykata Komunale në Prishtinë, gjykata gjeti se pas vdekjes së të ndjerit J,M në tërë pasurinë e paluajtshme trashëgimore e cila ka qenë e evidentuar në pronësi të tij, është shpall trashëgimtar i vetëm ligjor i biri i tij këtu paditësi I.M. Ndërsa nga Aktvendimi i lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë e Komunës së Obiliqit e datës 25.11.2002, gjykata gjeti se ky organ e ka aprovuar kërkesën e paditësit për zbatimin e ndërrimeve në operatin kadastral mbi bazën e aktvendimit mbi trashëgiminë.

Nga ekspertiza gjeodezike dhe pas daljes në vendshiqim me ekspert gjeodet, gjykata beri identifikimin e ngastrës objekt shqyrtimi dhe u vërtetua fakti se në vendin ku ishte bërë ekspropriimi duke përfshirë edhe ngastrat tjera nuk kishte deponi e as hapje të tunelit, por ngastra e lartshënuar dhe ngastrat tjera të ekspropriuuar pjesë e aktvendimit ishin të shndërruara në kullosa apo livadhe.

Eksperti i gjeodezisë në mendimin e tij me shkrim të datës 15.08.2013, në të cilin palët ndërgjyqëse nuk kishin vërejte, ka konstatuar se e paditura P.sh. "Iber Lepenci" është pronare e ngastrës kadastrale nr. ____-0, lloji i pronës: parcelë, zona rurale, në sipërfaqe prej S=863 m², në vendin e quajtur "____" në Fshatin Sh, Komuna Obiliq, të cilën palujtshmeri e ka bartur në emër të vetin në bazë të Aktvendimi i Sekretariatit për Financa KK Prishtinë 07.nr.465-23/81 datës 10.07.1981, nën numrin rendor 3. Kjo pronë ka qenë pronë e paraardhësi të paditësit tani të ndjerit J.M. Eksperti ka konstatuar se tani në shfrytëzim faktik të ngastrës ishte paditësi dhe se ditën kur është dal gjykata me ekspertin dhe është identifikuar ngastra në fjalë, gjendja e ngastrës nr. ____-0 kishte ndryshuar ngase nga ana jugperëndimore ishte bërë zgjerimi i rrugës së asfaltuar që lidhë fshatin me rrugën Sllatinë -Drenas dhe rruga për Obiliq, në një gjerësi prej 8.00m dhe tërë gjatësinë e ngastrës prej 45.50m, të shprehur në sipërfaqe prej S=375m². Ngastra objekt shqyrtimi ishte e shndërruar në kullosë, kurse në veri perëndim të ngastrës, në kufi të saj, ishte hapur një rrugë e pa asfaltuar që lidhë lagjen tjetër në juglindje të fshatit. Edhe nga certifikata me numër të lëndës 05-1568-23 e datës 17.10.2023 lëshuar nga Komuna e Obiliqit për ngastrën kadastrale P-____-____-0, gjykata vërtetoi se edhe tani kjo ngastër evidentohet në pronësi të të paditurës Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër - Lepenc" Sh.a.

Mbi bazën e të lartcekurave, gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditësit sa i përket kthimit të pronësisë së ngastrës P-____-____-0 ZK Sh. Komuna Obiliq është e pabazuar dhe të njëjtën vendosi ta refuzoj në tersi.

Bazuar në kohën kur është krijuar raporti juridiko-civil mes palëve ndërgjyqëse, gjykata gjeti se në rastin konkret gjen zbatim Ligjit mbi Ekspropriimin, i miratuar me datë 28 Prill 1978. Në nenin 21 paragrafi 3 të Ligjit mbi Ekspropriimi është përcaktuar se: "*Vendimi në formë të prerë mbi ekspropriimin do të anulohet edhe në bazë të kërkesës së pronarit të përparshëm, të pasurisë së patundshme të ekspropriuuar, nëse shfrytëzimi i ekspropriimit në afatin prej 3 vitesh ç'prej se vendimi ka marrë formë të prerë nuk ka kryer, sipas natyrës së objektit, punime të nevojshme në atë objekt.* Ndërsa paragrafi 4 i këtij neni përcakton se: "*Pasi të kalojnë 10 vjetë nga dita kur vendimi ka marrë formë të prerë mbi ekspropriimin nuk mund të paraqitet kërkesa për anulimin e atij vendimi*". Në bazë të dispozitave të lartcekura ligjdhënësi ka paraparë mundësin e anulimit të vendimit për ekspropriim dhe kthimin e pronësisë së pasurisë së ekspropriuuar tek pronari i tokës nëse shfrytëzuesi i ekspropriimit nuk ka kryer, sipas natyrës së objektit, punime të nevojshme në atë objekt e që në rastin e kësaj lënde mjaftueshëm është vërtetuar se deri më tani pra pas kalimit të të periudhës 30 vjeçare shfrytëzuesi i ekspropriimit këtu e paditura pasurinë e shpronësuar nuk e ka shfrytëzuar në përputhje me qëllimin për të cilin edhe është ekspropriuuar pasuria, pasi që nga dalja në terren me ekspert gjeodet është vërtetuar se ngastra objekt shqyrtimi ishte e shndërruar në kullosë dhe të njëjtën e ka në posedim këtu paditësi.

Nga provat të cilat janë administruar në shqyrtimin kryesor, rezulton se vendimi mbi ekspropriimin e pronës së paluajtshme është marrë me datën 10.07.1981, ndërsa padia e paditësit për kthimin e pronësisë është e datës 19.11.2010, çka rezulton se padia është paraqitur rreth 29 vite, nga dita kur vendimi mbi ekspropriimin ka marrë formë të prerë. Në prani të këtyre rrethanave Gjykata vlerëson se paditësi ka lëshuar çdo afat ligjor të përcaktuar në nenin 21 par.4 të Ligjit mbi Ekspropriimi të vitit 1978, mbi bazën e të cilit paditësi padinë është dashur të

paraqet brenda afatit ligjor 10 vjeçar nga dita kur vendimi mbi eksproprijimin ka marrë formë të prerë, mbi bazën e ekzistimit të rrethanës së shfrytëzuesi i eksproprijimit këtu e paditura pasurinë e eksproprijuar nuk e ka shfrytëzuar në përputhje me qëllimin për të cilin është bërë eksproprijim, paditësi do të kishte mundësi të kthente pronësinë e pasurisë së eksproprijuar.

Sa i përket rrethanës së legjitimitetit aktiv të paditësit gjykata vlerëson se i njëjti ka legjitimitet për të qenë palë në procedurë pasi që i pakontestueshëm është fakti se babai i tij ka qenë pronar i pasurisë së paluajtshme e cila është eksproprijuar dhe trashëgimtar i vetëm i J,M është shpallur këtu paditësi, andaj në rastin konkret gjykata vlerëson se kemi të bëjmë me të drejta të bartshme dhe mbi këtë bazë del legjitimiteti aktiv i palës paditëses në këtë procedurë.

Meqenëse Gjykata nuk është e lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë, në momentin e vendosjes, shqyrtoj edhe bazat tjera për aprovimin e padisë së paditësit. Në këtë drejtim pati parasysh edhe rrethanën se paditësi ngastrën objekt shqyrtimi që nga koha kur është realizuar eksproprijimi dhe tani në ditët e sotme e ka në posedim faktik, mirëpo në rastin e kësaj çështje juridike është e palejueshme zbatimi i bazës ligjore të fitimit të pronësisë përmes parashkrimit fitues mbi pronësinë shoqërore, kjo mbështetur në nenin 29 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore, i datë 30 janar 1980, në të cilin parashihet se: *“Mbi sendin në pronësinë shoqërore e drejta e pronësisë nuk mund të fitohet me parashkrimin fitues.”*. Gjykata ka patur parasysh edhe Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e LMThJP Gazeta Zyrtare RSFJ nr.6/80 (SL.List SRJ, br.29/96), mirëpo vlerëson se i njëjti nuk është ligj i zbatueshëm në Kosovë. Kjo për faktin se pas përfundimit të luftës në Kosovë (vitet 98-99), çështja e legjislacionit në fuqi është e përcaktuar me nenin 1 të Rregullores së UNMIK nr.1999/24, me të cilin është përcaktuar se ligji në fuqi në Kosovë do të jetë: a) rregullorja e shpallur nga PSSP dhe instrumentet e nxjerra në përputhje me të dhe b) Ligjet që kanë qenë të aplikueshme deri me 22.03.1989. Me dispozitën e lartcekur nuk është përcaktuar si ligj i zbatueshëm edhe ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që ishin në fuqi me datën 22.03.1989, edhe pse në fuqi mund të janë edhe ligjet pas kësaj date, e të cilat nuk janë diskriminuese dhe që konform me nenin 1.3 të kësaj rregulloreje, gjykata, organi ose personi përjashtimisht mund ta zbatojë atë ligj, në rast se një çështje nuk ka qenë e rregulluar me ligjet e datës 22.03.1989.

Për më tepër edhe me dispozitën e nenit 23 par. 1 të Ligjit nr.08/L-125 për Pronën Publike, përcaktohet në mënyrë shprehimore se: *“Në pronat në pronësi publike nuk mund të fitohet pronësia përmes parashkrimit fitues si dhe me ndërtimin e objektit, në kundërshtim me legjislacionin përkatës që rregullon të drejtën e ndërtimit dhe ndërtimin.”*

Gjykata rithekson se konform nenit 2 par.1 të LPK-së, vendos vetëm brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse, e që në rastin konkret kërkesë e vetme dhe kryesore e paditësit ka qenë kthimi – vërtetimi i pronësisë.

Lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata vendosi që secila palë ti bartë shpenzimet e veta në bazë të nenit 450 të LPK-së, kjo për faktin se asnjëra nga palët ndërgjyqëse nuk i kanë kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
-Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil -

Numri i lëndës: 2020:055328
Datë: 11.12.2023
Numri i dokumentit: 05043437

C.nr. 2432/20, date 11.12.2023

Gjyqtari,
Ibrahim Maloku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj Gjykate.